

V E N D I M
Nr. 634, datë 30.11.2000

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMET NR.357, DATË 7.7.2000, NR.511, DATË 21.9.2000, NR.567, DATË 23.10.2000, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, DHE NË PLANIN E SHPRONËSIMEVE PËR VITIN 2000, PËR MINISTRINË E TRANSPORTIT, NË OBJEKTET ME FINANCIM TË HUAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 7 dhe 9, të ligjit nr.8554, datë 10.12.1999, “Për buxhetin e shtetit të vitit 2000”, me propozimin e ministrit të Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr.357, datë 7.7.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë në buxhetin e vitit 2000 për Ministrinë e Transportit”, në zërin “shpronësime, për objektet me financim të huaj”, pasqyra e fondeve buxhetore shtesë për vitin 2000 në zërin “shpronësime”, ndryshohet sipas pasqyrës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Në vendimin nr.511, datë 21.9.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë në buxhetin e vitit 2000, për Ministrinë e Transportit”, tabela për fondet shtesë për shpronësime, TVSH dhe kosto lokale, sipas objekteve që financohen nga donatorë të huaj, ndryshohet sipas pasqyrës nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Në vendimin nr.567, datë 23.10.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë në buxhetin e vitit 2000, për Ministrinë e Transportit”, në zërat “shpronësime dhe TVSH, për objektet me financim të huaj” ndryshohet sipas pasqyrës nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Nga fondi prej 4 milionë lekësh, i planifikuar për vitin 2000 për shpronësimet e segmentit rrugor Librazhd, të zbriten 3 milionë lekë.

5. Diferenca e krijuar nga këto ndryshime të rishpërndahet sipas pasqyrës nr.4 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ministria e Transportit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

Pasqyra Nr.1

PËR NDRYSHIMET E FONDEVE TË V.K.M. NR.357, DATË 7.7.2000, PËR SHPRONËSIMET

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Fondi shtesë sipas V.K.M. Nr.357, dt.7.7.2000 për shpronësimet	Fondi i ndryshuar për shpronësime	Diferenca
1.	Segmenti Vorë-Sukth	58 000	58 000	0
2.	Segmenti Rogozhinë-Elbasan	162 000	162 000	0
3.	Segmenti Kapshticë- Korçë	60 000	56 700	3300
4.	Segmenti Kakavijë-Gjirokastër	50 000	50 000	0
5.	Segmenti Sukth-Durrës	30 000	30 000	0
6.	Segmenti Durrës-Rrogozhinë	20 000	20 000	0
7.	Segmenti Rrogozhinë-Lushnje	20 000	20 000	20 000

	Gjithsej	400 000	376 700	23 300
--	----------	---------	---------	--------

Pasqyra Nr.2

PËR NDRYSHIMET E FONDEVE TË V.K.M. NR.511, DATË 21.9.2000,
PËR SHPRONËSIMET

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Fondi shtesë sipas V.K.M. Nr.511, dt.21.9.2000 për shpronësimet	Fondi i ndryshuar për shpronësimet	Diferenca
1.	Lidhja e rrugës së re në Shullaz (Milot)	2100	21 00	0
2.	Segmenti Vorë-Sukth	27 000	18 000	9000
3.	Sukth-Durrës	30 000	55 00	24 500
4.	Rrogozhinë-Elbasan	13 000	13 000	0
5.	Korçë-Kapshticë	30 000	0	30 000
6.	Kakavijë-Gjirokastrë	30 000	18 000	12 000
7.	Durrës-Rrogozhinë	17 900	1400	16 500
8.	Milot-Lezhë	4500	0	4500
	Gjithsej	154 500	58 000	96 500

Pasqyra Nr.3

PËR NDRYSHIMET E FONDEVE TË V.K.M. NR.567, DATË 23.10.2000,
PËR SHPRONËSIMET

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Fondi shtesë sipas V.K.M. Nr.357, dt.7.7.2000 për shpronësimet	Fondi i ndryshuar për shpronësimet	Diferenca
1.	Sukth-Durrës	20 000	20 000	0
2.	Rrogozhinë-Lushnje	20 000	0	20 000
3.	Kakavijë-Gjirokastrë	20 000	0	20 000
4.	Rrogozhinë-Elbasan	10 000	0	10 000
5.	Korçë-Kapshticë	10 000	0	10 000
	Gjithsej	80 000	20 000	60 000

Pasqyra Nr.4

PËR RISHPËRNDARJEN E FONDEVE TË SHPRONËSIMEVE NË TVSH DHE KOSTO LOKALE
PËR VITIN 2000

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Fondi shtesë për TVSH	Fondi shtesë për kosto lokale	Totali
1.	Durrës-Rrogozhinë	27 500		27 500
2.	Rrogozhinë-Lushnje	25 000		25 000
3.	Rrogozhinë-Elbasan	25 000		25 000
4.	Durrës-Sukth	25 000		25 000
5.	Vorë-Sukth	25 000		25 000
6.	Librazhd-Qukës	30 300	25 000	55 300
	Gjithsej	157 800	25 000	182 800